

# Intervistë me prof.dr. Karl Kaser, ligjërues i Historisë së Evropës Juglindore në Universitetin e Grazit (Austri) **Para se të vendoset mbi statusin e ardhshëm të Kosovës, duhet të ketë një administratë efikase**

**"Është e sigurt se në Kosovë nuk do të ketë më sundim serb. Veç tjerash, derisa këtu janë trupat ndërkombëtare paqeruajtëse është e parëndësishme se çfarë statusi do të ketë Kosova", thotë z. Karl Kaser**

**SYLË URSHINI**

**PRISHTINE, QERSHOR** - Kontribut të veçantë në historinë e popujve të Evropës Juglindore, në këtë mes edhe të popullit shqiptar, kanë dhënë shkencëtarët evropianë, sidomos ata nga hapësira gjer-manofone, të cilët, mbase nga fakti që Perandoria Austro-Hungareze për kohë të gjatë dominoi mbi popujt e Ballkanit, datat marrë intensivisht me raportet e popujve të këtyj tajori konfliktuoz gjatë historisë. Edhe për historinë e shqiptarëve kontributi i albanologëve e dijetarëve austriakë ka qenë dhe vazhdon të mbetet i jashtëzakonisht. Ky interesim i historianëve dhe albanologëve austriakë, përkundrazi rritet në herëpas-herë, është prezent edhe tani. Në këtë mes duhet veçuar sidomos prof.dr. Karl Kaser, ligjërues ordiruar i Historisë së Evropës Juglindore në Universitetin e Grazit, i cili deri tani ka shkruar një monografi dhe punimsh shkencore mbi historinë e shqiptarëve. Në vazhdim e botimeve të tjera vlen të përmendet monografia: "Kosovomit, faktet, datat... të cilin e botoi në vitin 1999 së bashku me Wolfgang Petritschin dhe Robert Pichler. Në muajin gusht ky autor do të botojë librin "Mjësia dhe armiqësia në Ballkan". Profesori i njohur austriak Karl Kaser është njëkohësisht edhe drejtor i Centre for the Study of Balkan Centres. Këtu dihet si ishte në Kosovë, të cilin e vizitonte pas një periudhe gjatë dhjetëvjeçare, me çrast në Prishtinë, në Bibliotekën Kombëtare, mbajti një ligjëratë me temën "E ardhurja e Kosovës: Çfarë mund të kontribuon një historian për këtë", të cilin e kishte organizuar në mënyrë brilante drejtuesi i WUSS-it austriak, dr. Erner Hoxhaj. Për fat të keq, mediat tora të shkruara dhe elektronike, ose nuk ishin në dijeni ose nuk ishin të interesuara, nuk e shënuan me asnjë rresht dhe fjale këtë eventim të rëndësishëm kulturor-shkencor. Mysafirin nga Austria, prof.dr. Karl Kaser, e takuan në hotelin "Grandi", i shoqëruar gjatë përherë nga historianin ynë i njohur Erner Hoxhaj, me të cilin po bisedonin, krahas zhvillimeve aktuale politike në Kosovë, edhe për mundësinë e zgjerimit të vashkëpunimit ndëruarshëm midis Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit të Grazit. Me z. Karl Kaser biseduam për probleme të ndryshme nga fusha e historisë, por gjithsesi edhe për zhvillimet e pasluftës në Kosovë si dhe për konfliktin aktual në Maqedoni, rreth të cilave ai paraqiti pa bezitimi pikëpamjet dhe këndvështrimet e tij prej historiani dhe eksperti për Evropën Juglindore.

"Koha ditore": Zoti Kaser, ditë më parë keni mbajtur një ligjëratë jashtëzakonisht brilante, "E ardhurja e Kosovës: Çfarë mund të kontribuojë një historian për këtë?". A mund të flisni dikur për përmasat dhe interesin e kësaj ligjërate?

Karl Kaser: Në radhë parë, unë

jam i lumtur që po vizitoj Kosovën dhe që kam rastin të komunikoj me studentët dhe historianët shqiptarë. Dhe shpresoj se pas këtyj qëndrimi do të fillohet me një bashkëpunim më intensiv midis Universitetit të Prishtinës dhe Universitetit të Grazit. Tani t'ju këthehem pyetjeve, kur mendojmë për historianin, në të njëjtën kohë mendojmë edhe për të kaluarën. Historianët k gjithmonë kanë shkruar pozitivisht dhe negativisht mbi të ardhmen e një vendi. Punimet e tyre negative shpeshherë nuk i kanë shkruar me dëshirë, por kanë qenë të imponuara nga politika ditore. Në historianët kemi më pak apo më shumë një lojë monopoli mbi të kaluarën, dhe meqë kemi këtë monopol, atëherë ne luajmë edhe një rol të rëndësishëm për të ardhmen. Mendoj se historianët në shoqëritë ballkanike luajnë rol më të madh sesa historianët në shoqëritë evropiano-perëndimore. Për këtë arsye historianët këtu kanë përgjegjësi më të mëdha si për zhvillimet aktuale, ashtu për zhvillimet e ardhshme. Historianët mund t'i ndërtojnë linjat e të ardhmes. Po kështu, historianët duhet të tregojnë se identiteti nacional i njerëzve nuk është i vetmi, por ka edhe identitete tjera. Prandaj, mendoj unë, në Kosovë përgjegjësia e historianëve është më i madh sesa te ne në Austri. Historianët dhe historiografia nuk duhet të jetë në shërbim të politikës ditore. Nëse e bëjmë një formulim gjeneral, së pari kanë folur armët, pastaj historianët. Prandaj, kërkesë e rëndësishme e kohës është që të nënvizohet vlera e historiografisë, ajo vlerë do të ishte pavarësia e historiografisë. Pavarësia e saj duhet të jetë një e mirë dhe vlerë që duhet të ruajmë dhe kultivojmë. Pra, një gjë e tillë vlen edhe për historianët e Kosovës.

"Koha ditore": Kur flasin mbi historinë e Kosovës, gjithmonë kontrastohet me dy versione mbi të kaluarën e saj: versionin shqiptar dhe atë serb. Si e shihni ju si historian austriak këtë problem historiografik?

Kaser: Mua, si historian austriak, ajo që më befason më së shumti, është shtruarja e pyetjeve rreth asaj se kush ka jetuar i pari në tokën e Kosovës, me pretendimin që i pari duhet të ketë më shumë të drejta dhe avantazhe kundrejt palës apo grupit tjetër, që ka ardhur më vonë aty. Për mua një debat i tillë është i çuditshëm dhe krejt i parëndësishëm. Në historianët duhet të pranohet se për periudhën e antikës, respektivisht për periudhën midis ilirëve dhe dyndjes së slavëve, respektivisht për periudhën të gjatë pyetjeve. Dhe, nësi historian nuk duhet të lejojë që kjo rrethanoje që shfrytëzohet për motive politike. Sipas mendimit tim, çështja e kontinuitetit të ilirëve në territorin e Kosovës, është ende e diskutueshme.



Karl Kaser

hipotetikë, megjithë gjasat për një kontinuitet iliro-shqiptar janë të mëdha. Mirëpo, fundja çfarë domethënë kontinuitet? Barta e gjenëve nga një brez tek tjetri. Periudha në fjalë është karakterizuar me thyrje të mëdha kulturole e demografike.

Në anën tjetër, pala serbe paraqet versionin e saj krejt të kundërt me atë të palës shqiptare, megjithëse në raste të caktuara ajo edhe nuk e përjashton krejtësisht mundësinë e kontinuitetit iliro-shqiptar në Kosovë. Mirëpo, serbët, sidomos regjimi i Milosheviçit, e ka këqijdorur historiografinë, historianët serbë janë vënë në shërbim të politikës agresive dhe kanë shtrëmbëruar dhe keqinterpretuar Betejën e Kosovës (1389). Megjithatë, prijësi kryesor ka qenë serbë, aty kanë marrë pjesë edhe shqiptarët dhe të tjerët. Mbi të gjitha, kur flasim për Betejën e Kosovës duhet të kemi parasysh një fakt, në atë periudhë ende nuk kemi pasur kombë të formuara në kuptimin e sotëm, domethënë me shumë ka qenë fjala për një lojë identiteti konfesional sesa nacional.

Pos tjerash, unë mendoj se historia e këtyre dy popujve të Ballkanit nuk është e pershkuarë gjithmonë me luftëra, ashtu siç paratitet ajo nganjëherë. Mirëpo, shqiptarët dhe serbët në kohën më të gjatë të historisë kanë jetuar në paqe. Historia e këtyre dy popujve është e mbingakuar me vuajtje për kombin përkatës dhe ky keqinterpretim edhe ka ashpëruar në pas edhe raportet politike në Kosovë. Një interpretim i këtyre i historisë ka mobilizuar lehtë masat për qëllime politike.

"Koha ditore": Dert tani keni shkruar shumë monografi dhe punime shkencore mbi historinë e shqiptarëve. Ndërsa, para një viti e më tepër librin "Kosova: mjet, faktet, datat...", keni shkruar, po me Robert Pichler, edhe një politikian e diplomat i lartë austriak Wolfgang Petritsch, i cili, mbase, edhe ka mundur të ushroj ndikim mbi ju. Sa keni qenë aty i paanshëm dhe cilat burime i keni shfrytëzuar, keni përdorur vetëm burime perëndimore apo edhe burime shqiptare dhe serbe?

Kaser: Ndoshita kam përdorur më

shumë literaturë shkencore serbe sesa shqiptare, por nuk i kam numëruar asnjëherë sa burime serbe e sa shqiptare kam shfrytëzuar. Unë jam përpjekur të paraqes pikëpamjet e mia historike mbi zhvillimet në Kosovë. Aty nuk paraqes as pikëpamjet serbe dhe as ato shqiptare, por vetëm pikëpamjet e Karl Kasert. Derisa nga intelektualët shqiptarë libri është është pritur kryesisht mirë, intelektualët serbë janë shprehur tepër negativisht, por shpresoj se edhe në Beograd do të ketë evlurim dhe do të paraqiten intelektual që do ta vlerësojnë realisht këtë libër.

"Koha ditore": Zoti Kaser, para kësaj here ju keni qenë edhe njëherë tjetër në Kosovë, diku para dhjetë vjetësh. Brenda kësaj periudhe Kosova dhe shqiptarët kanë përjetuar aparteidin, shpëtyrjen dhe terrorin serb dhe se fundi edhe prezencën ushtarake e civile të OKB-së. Çfarë ndryshimesh shihni ju për këto periudha?

Kaser: Si para dhjetë vjetësh edhe tani në Kosovë ka një prezencë të sforcuar ushtarake-police. Mirëpo, prezenca e tarishme ndryshon prej asaj serbe, meqë tani këtu po bëhen përpjekje të konstitutimit ndërkombëtar për të vendosur paqë të qëndrueshme. Mirëpo edhe prezenca aktuale ushtarake e policore ka edhe anën e saj shqetësuese. Përse është e nevojshme një prezencë kaq e madhe ushtarake e policore në Kosovë?

"Koha ditore": Meqë spiralla e dhunës ende është e lartë dhe për këtë shqiptarët bëjnë bashkëfajtorë administratën ndërkombëtare, e cila, sipas tyre, i ka në ligëncat në duar për ta luftuar krimin dhe dhunën.

Kaser: Po, është e vërtetë se shqiptarët nuk i kanë kompetencat që i përmerdi ju. Mirëpo, po t'i kishin ata në duar këto kompetenca, a do të kishim një administrim më të mirë në Kosovë. Unë do të thoja, jo. Siç dihet, në dhjetë vjetet e fundit shqiptarët ishin të përjashtuar nga të gjitha institucionet e Kosovës, pra edhe nga policia, dhe për këtë arsye ata kanë humbur deri diku ndjeshmërinë për të marrë menjëherë përsipër kompetencat, dhe me këtë edhe përgjegjësinë. Në këtë kontekst, unë mendoj se është jo e qëllueshme që tani shqiptarët të kenë në duar të gjitha kompetencat.

"Koha ditore": Në anën tjetër, shumë analistë perëndimorë tërheqin vërejtjen se pa një vendim mbi statusin e ardhshëm politik të Kosovës, administrata ndërkombëtare e KB-së nuk do të jetë në gjendje të vendosë qetësinë e dëshirueshme.

Kaser: Unë mendoj se është e kundërta. Para se të vendoset mbi statusin e ardhshëm të Kosovës, duhet të ketë një administratë efikase dhe, mbi të gjitha, një administratë që nuk do të drejtohet

nga Korbet e Bashkuara, por një administratë të organizuar nga vetë shqiptarët. Pra, çështja e sigurisë nuk mund të lidhet duke marrë parasysh çështjen e statusit të ardhshëm të Kosovës.

"Koha ditore": Mirëpo, ka rëndësi, bile edhe në mesin e shqiptarëve, se mbetje pezall e statusit të Kosovës e len gjenden të tendosur dhe të paqëndrueshme.

Kaser: Mirëpo, gjithashtu duhet tërësi se bashkësia ndërkombëtare e ka bërë shumë të qartë se Kosova të paktin do të ketë një autonomi substanciale. Kjo do të thotë se shqiptarët do ta kenë fjalën kryesore në qeverisjen autonome të Kosovës. Gjithashtu, kjo do të thotë se edhe pakica serbe do të ketë një rol të caktuar në shoqërinë kosovare. Prandaj, argumentimet e tilla janë të paqëndrueshme. Fundja, është e sigurtë se në Kosovë nuk do të ketë më sundim serb. Veç tjerash, derisa këtu janë trupat ndërkombëtare paqeruajtëse është e parëndësishme se çfarë statusi do të ketë Kosova.

"Koha ditore": Mirëpo, sa mund të dillet për një bashkëjetesë shqiptaro-serbe, kur lufta ka mbaruar vetëm që dy vite, njëzetë tetë mijë i kanë të brekshta plagët e lufës, të zhdokurit, varret massive, të burgosurit...?

Kaser: Natyrisht, unë nuk i vë në dyshim këto vuajtje të shqiptarëve: dëbimet, vrasjet, vuajtjet, përndjekjet, dhunat, varret massive, të cilat janë përjetime të tmerrshme dhe smund të harrohen shpejt.

"Koha ditore": Që prej disa muajsh po vazhdojnë luftimet në Maqedoni. Mjësia shqiptare janë detyruar të braktisin vatrën e tyre në Maqedoninë lindore dhe perëndimore dhe të vendosen në Kosovë. Si qeveria e Shkupit, ashtu edhe Ushtria Çlirimtare Kombëtare (UÇK) këmbëngulli në pozicionet e tyre. Cili është mendimi juaj për këtë konflikt?

Kaser: Shikuar nga zhvillimet aktuale, situata atje është jashtëzakonisht serioze edhe pse këto ditë kanë pushuar luftimet dhe janë interesifikuar bisedimet. Luftimet do të zgjin për aq kohë derisa të gjitha palët relevante të tregohen të gatshme për zgjidhjen e statusit të ardhshëm të popullatës shqiptar në Maqedoni. Mendoj se edhe Ushtria Çlirimtare Kombëtare (UÇK) nuk do të jetë e gatshme t'i lëshojë armët pa zgjidhjen e këtij statusi. Prandaj, do të kaloj edhe një kohë e konsiderueshme derisa gjitha palët ushtarake dhe politike të tregohen të gatshme për negociata substanciale dhe brenda kësaj kohe do të ketë shumë viktime. Madje, nëse nuk përkeqësohet situata shteti maqedon mund të shpërbehet. Natyrisht, kjo do të ishte një katastrofë e madhe për tërë rajonin, meqë flakët e lufës do të mund të përhapeshin edhe gjetu.